**VENDIM**
**Nr. 380, datë 26.4.2017**

# PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 274, DATË 6.4.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS QË LIDH NDËRTESËN E RE TË QENDRËS DISPEÇER DHE ZYRAT E "OST", SH.A.-SË, ME NËNSTACIONIN 400 KV KASHAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 274, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Tabela e përmendur në pikën 1 zëvendësohet me tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 6 330 (gjashtë mijë e treqind e tridhjetë) m$^2$, "tokë bujqësore arë", vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 702 225 (dy milionë e shtatëqind e dy mijë e dyqind e njëzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 702 225 (dy milionë e shtatëqind e dy mijë e dyqind e njëzet e pesë) lekësh, të përballohet nga fondet e "OST", sh.a.-së.".

2. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, "OST", sh.a.-ja, dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

**OPERATORI SISTEMIT TE TRANSMETIMIT**

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË RRUGES QË LIDH QENDRËN DISPECER ME NËN/STACIONIN 400 kV TIRANA 2**

| Nr. | Lista e pronarëve për shpronësim definitiv (sip. tokë bujqësore) | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atësia | Mbiemri | Lloji i pasurisë | Nr. Kadastral | Nr. Pasurisë | Prona në m² (totale) | Gjendja juridike nga ZVRPP | Sip. rrugë m² | Cmimi i tokës lek/m² | Vlera në lek për tokën | Llloji i kulturës | Cmimi i kulturës në lek/ha | Vlera në lek për kulturën | Vlera totale në lek | Shënime |
| **Qarku Tiranë** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| **Njesia Administrative Kashar** | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Ali | Shaban | Sula | arë | 2105 | 1/19 | 1565 | pronar | 180 | 415 | 74700 | asëll | 73000 | 1332 | 76032 | çertifikatë 23.11.2007 |
| 2 | Ali | Shaban | Sula | arë | 2105 | 9/1/ | 2650 | pronar | 130 | 415 | 53950 | asëll | 73000 | 962 | 54912 | pa çertifikatë |
| 3 | kanal | | | | | | | shtet | 20 | | | | | | | |
| 4 | Xhemal | Ymer | Sula | arë | 2105 | 976/6/ | 1343 | pretendues | 220 | 415 | 91300 | rruge | | | 91300 | pa çertifikatë |
| 5 | Shkelqim | Osman | Sula | arë | 2105 | 976/10/ | 1440 | pretendues | 90 | 415 | 37350 | rruge | | | 37350 | pa çertifikatë |
| 6 | Hajdar | Ymer | Sula | arë | 2105 | 976/11/ | 2900 | pronar | 140 | 415 | 58100 | rruge | | | 58100 | çertifikatë 21.01.2007 |
| 7 | Ramazan | Hamza | Sula | arë | 2105 | 976/13/ | 4240 | pretendues | 185 | 415 | 76775 | rruge | | | 76775 | pa çertifikatë |
| 8 | Bashkim | Hamza | Sula | arë | 2105 | 976/14/1 | 16000 | pronar (b.p) | 800 | 415 | 332000 | rruge | | | 332000 | çertifikatë 20.07.2007 |
| 9 | Jakup | Ramazan | Murataj | arë | 2105 | 976//18/1 | 4650 | pretendues | 270 | 415 | 112050 | rruge | | | 112050 | pa çertifikatë |
| 10 | Mustafa | Ramazan | Murataj | arë | 2105 | 976//18/2 | 3675 | pronar | 200 | 415 | 83000 | jonxhe | 74000 | 1480 | 84480 | çertifikatë 09.01.2008 |
| 11 | Musa | Ramazan | Murataj | arë | 2105 | 976/18/5 | 4200 | pronar | 180 | 415 | 74700 | jonxhe | 73500 | 1332 | 76032 | çertifikatë 09.01.2008 |
| 12 | Muhamet | Ramazan | Murataj | arë | 2105 | 976/18/6 | 3910 | pronar | 160 | 415 | 66400 | miser | 73500 | 1184 | 67584 | çertifikatë 12.12.2008 |
| 13 | Musa | Ramazan | Murataj | arë | 2105 | 976/18/7 | 3911 | pronar | 240 | 415 | 99600 | miser | 73500 | 1776 | 101376 | çertifikatë 12.12.2008 |
| 14 | Lulzim | Pellumb | Beqiri | arë | 2105 | 115/12/ | 2650 | pronar | 800 | 415 | 332000 | miser | 74000 | 5920 | 337920 | çertifikatë 08.12.2003 |
| 15 | kanal | | | | 2105 | 440 | | shtet | 50 | | | | | | | |
| 16 | Rustem | Qerim | Sula | arë | 2105 | 116/2/ | 8800 | pretendues | 560 | 415 | 232400 | 25 rrënjë, ftonj, shegë, kumbulla | | | 232400 | pa çertifikatë |
| 17 | Rustem | Qerim | Sula | arë | 2105 | 117a | | pretendues | 260 | 415 | 107900 | jonxhe | 73500 | 1924 | 109824 | pa çertifikatë |
| 18 | kanal | | | | 2105 | 427 | | shtet | 45 | | | | | | | |
| 19 | Rustem | Qerim | Sula | arë | 2105 | 1118/1/ | | pretendues | 1800 | 415 | 747000 | ulli 1 rr, shegë 2 rr, mollë 3 rr, kumbu 6 rr, ftua 5 rr, total 21-24 | | 107090 | 854090 | pa çertifikatë |
| | | | | | | | | **SHUMA** | **6330** | | **2579225** | | | **123000** | **2702225** | |